



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-10157 /2022

Klinë: 30.03 2022

PROCESVERBAL

I Seancës së Kuvendit të Komunës të Klinës, mbajtur më 25.02.2022, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Seancën e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti kryetarin e komunës, nënkryetaren, komandantin e policisë, drejtorët e drejtorive, OSBE, mediat e pranishme, gjithë anëtarët e kuvendit dhe qytetarët e tjerë pjesëmarrës në këtë seancë. Tutje theksoi se akoma kemi nga pak probleme me furnizimin elektronik të materialeve për anëtarët e kuvendit por se shumë shpejt do të pajisen me laptop të ri ndërsa adresat elektronike që sot i kanë të konfirmuara dhe të dorëzuara në pliko të mbyllura. Kryesuesi konstatoi se nga 27 anëtarët e kuvendit, në sallë janë prezent 26 anëtarë dhe se për mungesën e anëtares Mendehie Duraku ka pranuar arsyetimin, prandaj seanca mund të vazhdojë me punime.

Kryesuesi Gashi gjithashtu prezantoi Rendin e Ditës dhe në lidhje me rendin e ditës hapi debat.

Sallën e merr:

Esat Raci, i cili pasi bëri përshëndetjet për të gjithë të pranishmit, theksoi: "Në lidhje me rendin e ditës, bashkë me shefin e grupit të LDK-së dhe LVV-së, për piken e 15-të e cila është "Pyetje dhe Përgjigje", jemi dakorduar që të mbetët ashtu siç ka qenë deri më tani, me gjithë respektin për propozimin e kryetarit të grupit të AAK-së, z. Valmir Bacaj të bërë në seancën e kaluar".

Kryesuesi theksoi se askush nuk ka dashur që të bëjë a tjetërsojë qëllimin e kësaj pike, thjeshtë ka qenë ideja që të racionalizohet koha dhe përgatitja e atyre që përgjigjen të jetë më e mirë.

Tjër...

z. F...

z. F...

z. F...

z. F...

z. Valmir Bacaj: Qëllimi i propozimit tim ka qenë jo të hiqet kjo pikë por të ju jepet mundësi drejtorëve dhe zyrtarëve të tjerë të na sjellin përgjigje më të detajuara dhe të sakta, përndryshe neve nuk na pengon që të mbetet edhe kështu siç ka qenë deri më tani.

z. Zafer Gashi: Për rendin e ditës grupi ynë kuvendar ka pasur një kërkesë i nderuar kryesues. E cila ka qenë për futjen në rend dite të propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e bursave me qëllim të rritjes së numrit të përfituesve të këtyre bursave sipas propozimit të anëtares së kuvendit, znj.Valmira Krasniqi. \nuk e shoh në rend dite dhe nuk e di pse nuk është fut ky propozim në rend dite.

z. Fadil Gashi, kryesues: Proceduralisht duhet parë se si mund të ndryshohet rregullorja në fjalë, nuk mjafton vetëm të propozohet dhe të merret si punë e kryer. Propozimi fillimisht duhet të kalojë në KPF dhe të shqyrtohet aty mundësia e rritjes së shumës së propozuar gjë që do të bëhet në mbledhjen e ardhshme të KPS-së. Më pastaj KPF rekomandon kuvendin. Po e jap mendimin tim personal, si të kryesuesit: Mendoj që rregullorja nuk ka nevojë të ndryshohet fare. Prandaj është praktikë që çdo vit kuvendi të vendosë për shumën që ndahet për bursa varësisht nga mundësitë buxhetore pa ndryshuar fare rregullore.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përsëritet për të gjithë. Sa i përket numrit të bursave ne do të fokusohemi në draft buxhetin që do të jetë pjesë e zhvillimeve të muajve në vijim dhe mendoj që nuk do të jetë e nevojshme që të ndryshohet rregullorja për numrin e bursave. Numri i bursave me buxhet të vitit të ardhshëm do të rregullohet.

z. Zafer Gashi: Është transkripti i seancës së kaluar ku kryetari pajtohet me propozimin vetëm se kërkon ndërhyrjen në rregullore, pikërisht në lidhje me rritjen e numrit për studentë përfitues si dhe nxënës sipas propozimit.

z. Fadil Gashi, kryesues: Se a ka nevojë a jo të ndryshohet pasi që të vije në seancën e ardhshme propozimi do ta shohim. Le ta procedojmë fillimisht sipas rregullores.

z. Tunë Dedaj: Unë në seancën e kaluar jam pajtuar që të rritet numri i bursave por jo në numër të jetë 50 a 60 por 100. Pra, le të shihet mundësia buxhetore që numri të rritet në 100 bursa.

z. Valmir Bacaj: Duhet të jemi transparent sa i përket deklaratave. Unë po e citoj procesverbalin se çfarë ka thënë kryetari, citoj: "Sipas planifikimeve buxhetore për këtë vit janë 30 bursa por ne i kemi rritur për 10 bursa më shumë. Për nxënës do të jetë një vendim i ri. Si propozim mendoj që duhet ta shqyrtojmë mirë bashkërisht dhe të marrim një vendim. Këtë mund ta realizoj më pastaj drejtorja e arsimit pasi t'i ketë marrë informacionet e nevojshme." mbyll citimin.

z. Zafer Gashi: Me datën 15 shkurt GAP i ka publikuar premtimet e kryetarëve të komunave dhe për bursat aty shkruan se Kryetari ka premtuar dyfishimin e numrit. Nga

30 në afërsisht 60. Tash po del 40. Pra, janë disa premtime që i ka dhënë kryetari prandaj në ato premtime po bazohemi.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Realisht nevoja e ndryshimit të rregullores mund të shihet vetëm tek shtimi i numrit të nxënësve sepse për studentë është rregullorja ekzistuese. Për numrin dhe shumën vendimin e merr kuvendi.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Edhe ne si grup kuvendar i LDK-së i bashkëngjitemi kërkesës së grupit të PDK-së që mos të ndryshohet pika "Pyetje e përgjigje" për shkak se nëse shkohet sipas propozimit të AAK-së, ajo mund të burokratizohet me procedura por edhe sepse mund të burojnë pyetje afër mbajtjes së seancës dhe është e nevojshme që të parashtrohen. Ne i arsyetojmë drejtorët nëse nuk janë të gatshëm të japin përgjigje të tanishme duke pasur mundësi që përgjigjet të jepen edhe në seancën e ardhshme, ashtu sikurse kemi pasur mirëkuptim ndaj përgjigjes mbi shqetësimin tonë, në fakt të shqetësimeve tona që i parashtruar në seancën e kaluar për drejtorin e arsimit e që shpresojmë që do t'i marrim sot përgjigjet.

z. Fadil Gashi, kryesues: Mos të krijohet përshtypja e atyre që po na ndjekin në radio se është heq kjo pikë. Kjo pikë nuk është heq, jua thash edhe në zyre. Nuk është heq pika e qysh dojmë më e modifiku vendosim të gjithë bashkë.

Pasi që nuk kishte debate të tjera në lidhje me Rendin e ditës, kryesuesi i Kuvendit kaloi në pikën e parë të Rendit të ditës: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi theksoi se në këtë seancë mungon me arsye vetëm znj. Mendehe Duraku

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar

Kishte vërejtje nga anëtarja znj. Valmira Krasniqi e cila theksoi se ka hasur disa gabime në procesverbal e që janë: Emri i saj është ngatërruar me emrin e anëtares tjetër znj. Lirije Gashi dhe se në propozimin e saj për shtimin e nxënësve në rregullore për bursa është shkruar numri 5 ndërsa propozimi ka qenë për 50 nxënës.

Kryesuesi e vendosi në votim procesverbalin me vërejtjet e bëra dhe me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Në lidhje me rekomandimet kryesuesi theksoi se të gjitha rekomandimet janë në vazhdimësi në Rend Dite përveç tre kërkesave që i janë drejtuar KPF. Këto kërkesa ai i prezantoi para anëtarëve të Kuvendit: 1. Lorenc Tuqaj kërkon për lirim nga qiraja komunale për lokalitë të cilat janë pronë e komunës- bufeja e komunës. Ai tha se kërkesa komplet është para anëtarëve dhe se rekomandimi i KPF-së ka qenë të kalojë në kuvend dhe të shqyrtohet shkak se gjatë vitit 2020 janë liruara të gjitha lokalet nga qiraja shkak i pandemisë për 6 muaj. Rekomandimi është që nëse na vjen një raport i vlerësimit ashtu siç na ka ardhur në të kaluarën, të trajtohen njëjtë të gjitha bizneset.

për

Pika

2020

2020

2020

2020

2020

z. Tunë Dedaj: e kam lexuar kërkesën dhe duke pasur parasysh se lokalet më të vërtetë janë dëmtuar gjatë kohës së pandemisë, propozoj që të lirohen me 50% nga qiraja me kusht që 50% tjetër të paguhet menjëherë nga qiramarrësit.

z. Valmir Bacaj: Pasi që të gjitha partitë politike i kemi përfaqësuesit në KPF, ne si grup pajtohemi që këto rekomandime të votohen si pako.

z. Fadil Gashi, kryesues: Janë edhe dy rekomandime që po i lexoj: Për Z. Viktor Gashi, të cilën kërkesë e kemi pasur edhe në të kaluarën. Rekomandimi është që në momentin që plotësohen kriteret ligjore do ta shqyrtojmë. Dhe e fundit është kërkesa e Ruzhdi Agushi i cili ka kërkuar që të ndihmohet për bashkëshorten e sëmurë e që KPF e ka rekomanduar tek zyra e kryetarit.

z. Arben Limanaj: Te kërkesa e z. Viktor Gashi për shfrytëzim të pronës publike për një fushë të sportit e shoh që kërkesa është për 100 deri në 110 hektarë. Të përmirësohet kjo pjesë sepse nuk besoj që i duhet dikujt 110 hektarë tokë për një fushë të sportit. Pajtohemi që të kalojë kjo kërkesë pasi të përmirësohet dhe të i plotësoj kriteret ligjore.

z. Esat Raci: Edhe ne si grup kuvendar pajtohemi që të kalojnë këto tre kërkesa me theks të veçantë kërkojmë nga zyra e kryetarit që në shumën sa më të madhe të ndihmohet z. Ruzhdi Agushi.

z. Zafer Gashi: E di që ka pasur edhe kërkesa të tjera të drejtuara për ndihmë dhe nuk e di a janë shqyrtuar të gjitha. Znj. Zahrije Krasniqi ka bërë një kërkesë të tillë dhe nuk e shoh tek rekomandimet.

z. Fadil Gashi, kryesues: Të gjitha kërkesat që kanë arritur në KPF i kemi shqyrtuar. Zonja në fjalë duhet parë kur e ka protokolluar kërkesën. Me siguri që do të vijë kërkesa e saj në mbledhjen e radhës të KPF-së.

Kryesuesi i vuri në votim rekomandimet e KPF-së dhe me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi Raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2021.

z. Zenun Elezaj, Kryetar: Sigurisht që në raport janë përfshirë të gjitha të arriturat gjatë vitit 2021 dhe jemi munduar që të kemi një përfshirje sa më të gjerë të të gjitha aktiviteve të realizuara. Për çdo paqartësi jemi këtu me ekzekutivin që mund të japim shpjegime.

z. Kushtrim Haliti: Përshëndetje. Kam pyetje për drejtorin e gjeodezisë dhe atë të Urbanizmit. Pyetja është për rrugën që lidh qytetin e Klinës më fshatin Dresnik. Gjatë fushatës është publikuar se rruga ka pasur koston rreth 600 mijë euro. Tani a janë ndërprerë punimet. Cila është arsyeja e ndërprerjes së punimeve? A nuk keni bërë shpronësimin e pronave private sepse shohim shirita të vendosur nga qytetarët e asaj pjese të cilët i kanë kundërshtuar këto punime nëpër pronat e tyre.

z. ...

4 ...

z. Zenun Elezaj, kryetar: Projekti në fjalë është projekt tre vjeçar i cili ka qenë projekt bashkëfinancimi nga Komuna e Klinës dhe Ministria e Infrastrukturës. Kjo e fundit ka ndërprerë marrëveshjen prandaj komuna po operon me buxhet të vetin. Po është e vërtetë që në teren kemi hasur në vështirësi dhe në disa pjesë na është dashur që të ngushtojmë rrugën. Në fund të fundit do të bëjmë edhe shpronësimin por deri atëherë jemi duke bërë përpjekje që të gjejmë mirëkuptim.

z. Kushtrim Haliti: Ka raste të tjera që ju keni shtruar rrugën në prona private dhe ju keni premtuar por akoma asgjë nuk keni bërë. P.sh. të salla e sporteve.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Tek Palestra e Sporteve realisht ka dalë që diku një ari është në pronën private dhe ne kemi menduar që mund të bëjmë ndërrim prone por me ligjin për ndërrimin e pronave është decidivisht e përcaktuar se ndërrimi i pronave mund të bëhet vetëm kur ato janë të kufizuara në afërsi direkte. Pra me ligj nuk kemi të drejt të bëjmë ndërrim prone nga Fshati Dresnik në qendër. Zyra ligjore na ka sugjeruar që të nisim me shpronësime.

z. Bledar Berisha: Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e drejtorisë për Shërbime Publike. Këtu kam raportin e punës. Në disa Projekte nuk është cekur shuma e projekteve që nuk më është dukur e arsyeshme.

z. Qendrim Millaku, Drejtor i SHPE: Përshëndetje për të gjithë. Nëse ka mundësi të më bëhet me dije për cilat projekte e ka fjalën z. Berisha. (Pasi që z. Berisha i përmendi projektet me emër, drejtori Millaku vazhdoi...) Këto projekte janë dy vjeçare dhe për mos gabuar në shuma të sakta, këto të dhëna do të jua sjell në seancën e ardhshme.

z. Zafer Gashi: Te raporti i punës unë kam pyetje rreth projekteve kapitale të përfunduara. Në tabelë shoh: ndërtimin e stacionit të autobusëve në Klinë shkruan që është i përfunduar, ndërsa tek kërkesa për bartjen e mjeteve është kërkuar të bartet shuma prej 25 mijë euro për ndërtimin e stacionit të autobusëve. Tjetra, Kryetari në debatet e më hershme ka dhënë zotim se nuk do të ketë më pagesa për punë shtesë e që në fakt e shoh këtu që megjithëkëtë janë bërë pagesa për punë shtesë. Dhe e fundit, tek projektet kapitale tek 2020-2021 dhe 2021-2022, nuk e lexova askund se sa deri tani janë paguar dhe dhënë para për trotuarin në Sferkë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Stacioni i autobusëve ka përfunduar fazën e parë. Vlera e kërkuar dhe planifikuar është për fazën e dytë. Projekti do të vazhdojë tutje me procedura të reja: Laurat, mbulesat e peroneve etj. Për Sferkë do të vazhdojë projekti për ndërtimin e trotuareve. Ndërsa për punën shtesë në projekte kam premtuar që do ta zvogëloj por se aty ku është e nevojshme do të na duhet gjë që është e paraparë edhe me ligj.

z. Arben Limanaj: Në parim si grup duhet të pajtohemi me raportin e Ekzekutivit për vitin 2021 sepse kemi qenë pjesë e një koalicionit të gjerë qeverisës por ajo që mendoj se nuk duhet të përsëritet është kushtëzimi i realizimit të projekteve në kohë fushate e

që ka qenë shumë e theksuar këtë fushatë të fundit. Është një shqetësim i madh që nuk duhet të përsëritet.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Mendoj që në raportin që do të merrni kur të vij koha do ta shikoni që çdo projekt i realizuar ka qenë i paraparë dhe planifikuar që më parë. Nëse ka shkelje këtu do të jemi.

z. Valmir Bacaj: Të gjithë e dimë që viti 2021 ka qenë një vit me sfida të mëdha shkakut i pandemisë. Ne e shohim si raport pozitiv të punës së ekzekutivit për vitin 2021.

Pika 5. e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit financiar janar- dhjetor 2021.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Të nderuar të pranishëm. Para se të filloj me prezantim të shkurtër të raportit, më lejoni që të theksoj se kamë vërejt tre gabime teknike dhe dua që të shënohen në procesverbal: Kategoria e subvencioneve në tabelarin e fundit sipas planit kontabël në fondin 21, kategoria ekonomike 200, shuma duhet të jetë: 338 mijë e 769 euro, e jo siç është : 339 mijë e 149 euro. Dhe shuma totale 345 mijë e 108 euro e 59 cent e cila do të futet me vlerën e njëjtë tek subvencionet në tabelën nr.3. Është kodi i shpenzimeve për blerjen e veturave zyrtare, shuma këtu i përket vitit 2020 e jo vitit 2021. Këto ishim gabimet teknike të gjetura që doja t'i theksoja paraprakisht. Z. Desku prezantoi raportin financiar Janar-dhjetor 2021 duke radhitur veç e veç të gjitha të hyrat dhe shpenzimet nëpër dikastere dhe krahasuar ato me vitin paraprak.

Kryesuesi i Kuvendit para se të jua jep fjalën anëtarëve të kuvendit në lidhje me raportin që posa e prezantoi drejtori Desku, përshëndeti aktivistin për mbrojtjen e ambientit i cili është prezent në sallë, z.Ragip Kryeziu.

z. Asdren Ramadani: Përshëndetje për të gjithë. Kur jemi te shpenzimet e buxhetit për këtë periudhë po vërehet që janë bërë rritje të panevojshme gjatë kësaj periudhe që karakterizohet edhe me fushatë elektorale. Janë rritë shpenzimet tek veturat që kanë pasur një rritje të dukshme krahasuar me vitet e tjera. Rritje ka pasur edhe tek shpenzimet për udhëtime zyrtare brenda vendin krahasuar me vitin e kaluar.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Në total gjatë prezantimit të raportit ju thash që shpenzimet për mallra dhe shërbime janë zvogëluar. Tani nëse ndalemi tek këto që i theksoi asamblisti Ramadani duhet at dimë që në vitin 2020 ka qenë vit i fillimit të pandemisë dhe lëvizjet me vetura kanë qenë më të vogla. Edhe mirëmbajtja e veturave është e natyrshme që ka kosto më të mëdha sepse janë blerë vetura të reja dhe numri i veturave është rritur. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të udhëtimit brenda vendit janë shpenzimet që bëhen për bartjen e nxënësve dhe jo të zyrtarëve të Komunës.

z. Zafer Gashi: Unë e përgëzoj drejtorin e financave, z. Aziz Desku për [profesionalizimin e tij në këtë raport. Më intereson tek arkëtimi i mjeteve nga pronat publike. A ka mundur të jetë ky arkëtim nga shfrytëzimi i pronave publike më i madh? Tek pjesa e shëndetësisë, pasi e bana një matematikë me numra po me del se për vitin 2021, nr.17. Shpenzimet të ndryshme shëndetësore për këtë periudhë janë 24,875.00 euro. Pajisje tjera 26,394.00 euro, nr. 27 furnizim mjekësor 79,415.00 euro, Pajisje

speciale mjekësore- 5,725.00 euro, Pajisje të tjera- 38,239.00 euro duke e mbyllur diku me 137,000.00 euro për vitin 2021 që janë dhënë për mjekësi e që mendoj se është vërtetë mirë nëse është kështu siç shkruan. A mundet që e tërë kjo herën tjetër të specifikohet dhe ta dimë se cilat pajisje qenkan blerë, për cilat pajisje konkrete paskan shkuar këto mjete?

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Kur flitet për shifra kam qef me qenë i saktë. Sa i përket shërbimeve të ndryshme shëndetësore bëhet fjalë për kompaninë që kryen shërbime shtëpiake. Për pajisje dhe barna i kemi të gjitha të dhënat e sakta dhe në detaje por këtë nuk e kam sot këtu, prandaj mund të vini në zyre të i merrni ose të jua sjell në seancën e ardhshme.

z. Ndrec Zefaj: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje për të gjithë. E kam lexuar këtë raport dhe në këtë rast janë disa pika që dua t'i adresoj në këtë pikë të rendit të ditës. Sa i përket shpenzimeve buxhetore për periudhën raportuese, përkatësisht shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit kanë një rritje të dukshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shuma e shpenzuar këtë periudhë të këtij viti është tepër e madhe dhe më duket e pa arsyeshme. Shpenzimet për karburante janë gjithashtu të mëdha krahasuar me vitin paraprak. Edhe pse drejtori e arsyetoi me pandeminë, duhet ta dimë që edhe në vitin 2021 kemi pasur pandemi dhe mbyllje totale. Kërkoj që të kemi kujdes sepse ka dallime të mëdha në shpenzime. Gjithashtu edhe tek shpenzimet e telefonisë mobile, janë të mëdha edhe pse ka ulje nga viti i kaluar. Kërkoj që të ketë kujdes në shpenzimet e parasë publike dhe se buxheti të investohet aty ku ka më shumë nevoja qytetare.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Mendoj që e dhashë përgjigjen më herët për këto lloj shpenzimesh për shpenzimet e udhëtimeve të nxënësve si dhe për karburante.

z. Kushtrim Haliti: Tek shpenzimet për udhëtimin e nxënësve, unë e di që në shumë fshatra ndoshta jo 50% por në 40% të fshatrave nuk barten nxënësit. P.Sh. në fshatin Jashanicë nxënësit udhëtojnë më shumë se sa 4 km në këmbë dhe kjo mbase është edhe arsyeja pse atyre më shumë ju pëlqen me ardhë në Klinë në shkollë se sa në fshat, sepse autobusi që qarkullon në relacionin Skenderaj- Klinë futet në fshat dhe i merr nxënësit dhe i bjen në Klinë. Pyetja tjetër: Sa prona të Komunës janë të dhëna me qira dhe sa janë të hyrat vjetore nga ato prona? Kush i shfrytëzon dhe a kanë kontrata valide për shfrytëzimin e tyre? Sa kam informacione disa nga lokalet e dhëna nga komuna me qira personave të ndryshëm, të njëjtin i kanë dhënë të njëjtat prona me qira tek dikush tjetër dhe marrin qira më të madhe se sa që Komuna merr nga ata.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Tek shpenzimet brenda vendit, procedurat udhëhiqen nga drejtorja e arsimit. Për më shumë detaje në seancën e ardhshme mund të ju sjellim informacione për shkollën në fjalë. Lokalet me qira janë lokale që shfrytëzohen me vite si të tilla. Ne jemi duke përgatit listën e pronave ekzistuese që nuk janë dhënë me qira e që do të jepen. Ndërsa për çështjen e dhënies me qira nga qiramarrësi i Komunës tek

një qiramarrës tjetër nuk kam informacione përveç për banesa që është thënë se ka ndodhë ashtu.

z. Esat Raci: Edhe ne si qytetar dhe Opozitë i gëzohemi të hyrave vetanake por nuk e dimë se nga kanë ardhur ato të hyra vetanake. Nuk e dimë nga kanë ardhur përveç nëse kanë ardhur nga gjorbitjet e qytetarëve.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Në tabelar në raport i keni të gjitha të dhënat dhe mund të shikoni se nga kanë ardhur ato të hyra.

z. Esat Raci: Gjobat nga trafiku a mund të dimë se sa janë?

z. Aziz Desku, Drejtor i FEZH: Gjobat e trafikut janë 276,796.80 euro. Dënimet nga gjykata 23,864.00 euro, gjoba nga inspektorati 6,542.00 euro

z. Arben Limanaj: Dëshiroj me ngrit një shqetësim tek pjesa e menaxhimit të situatës mbi shujtat e mësimdhënësve. Është obligim i komunës për shujtën ditore sipas kontratës kolektive. Vitin e kaluar afër 100,000.00 euro i kanë marr avokatët pasi nuk është menaxhuar mirë kjo çështje. Mendoj që e njëjta do të ndodhë edhe këtë vit nëse Komuna nuk ka marrë masa paraprake. Për diçka që është e rregulluar dhe është në letër, avokatët marrin mbi 90,000.00 euro, kjo është shumë shqetësuese.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Më së paku është përgjegjësi e Komunave kjo sepse në kontratën kolektive askund nuk është nënshkruese Komuna. Ti e din Arben se kufijt buxhetor i përcakton Ministria e Financave dhe ne nuk mund të dalim jashtë atyre kufijve prandaj në mungesë të mjeteve nuk mund t'i përmbushim këto pagesa dhe mësimdhënësit detyrohen të ju drejtohen instancave të tjera. Është për keq ardhje që jemi detyruar me pagu ato mjete për avokatë etj, por ka qenë jashtë mundësive tona të veprojmë ndryshe. Gjitha përpjekjet i kemi bërë që mos të kemi të njëjtën rrjedhje edhe këtë vit por nuk po varet nga ne. Kemi shpresuar që do ta realizojmë këtë muaj një pjesë të pagesave për shujta por nuk na e kanë realizuar me arsyetimin se ka pasur shumë formularë dhe skan arritur me i fut në sistem. Kemi nda mjete shtesë për kategorinë e pagave që të i përmbushim këto obligime.

z. Zafer Gashi: Drejtor a e keni seriozisht se nuk keni dijeni që ka lokale që janë dhënë me qira personit të tretë? Sepse inspektorët e komunës sonë e kanë evidentuar këtë gjë dhe kryetari e ka thënë se kjo çështje është në organet e hetuesisë.

z. Valmir Bacaj: Sa i përket raportit të financave për vitin 2021 në të tre kategoritë kryesore kemi trend pozitiv si në të hyra ashtu edhe në menaxhimin e tyre . Sa i përket shpenzimeve, realizimi i buxhetit në 95% shihet si performancë e shkëlqyer e ekzekutivit. Pastaj arkëtimi dhe rritja e të hyrave në 69% nga tatimi, nga qytetarët, shihet si besim i qytetarëve në këtë qeveri lokale në menaxhimin e mirë të parasë publike. Prandaj, ne si grup kuvendar e vlerësojmë këtë menaxhim të mirë të financave publike si vazhdimësi duke zbatuar ligjet në fuqi.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe Miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit për vitin 2021 dhe bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Meqenëse dihet se çdo herë kur kemi tejkalim të të hyrave vetanake në krahasim me buxhetin e aprovuar në Kuvendin e Komunës, është një procedurë formale që kërkon që të rritet buxheti i atij viti për t'u regjistruar në sistemin e menaxhimit të financave publike të Kosovës. Ju keni marrë një tabelar ku kemi rritje të të hyrave të realizuara në krahasim me të hyrat e planifikuara në vlerë prej 534,901.25 euro ku këtu nuk janë të përfshira gjocat e trafikut sepse ato që nga viti 2019 nuk planifikohen si të hyra komunale. Kjo është pjesa e parë sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ndërsa paralelisht me këtë kemi edhe një propozim për bartjen e mjeteve të mbetura nga viti 2021 në vitin 2022 në vlerën prej 1 milion e 196 mijë e 666 euro e 6 cent. Pra të gjitha këto mjete janë buxhet shtesë për vitin 2022 nga mjetet e bartura nga viti 2021.

Në vazhdim drejtori i financave , z. Desku shpjegoi veç e veç planifikimet nëpër kategori se nga sa mjetet nga këto mjete të bartura do të ndahen. Ai në fund tha se me këto mjete sipas rregullores duhet të financohen projekte të nisura nga viti i kaluar e jo projekte të reja. \dhe se për këto mjete akoma nuk kanë një dakordim nga Ministria e Financave dhe nuk e din se a do të mbetet kjo shumë apo do të ndryshoj.

z. Zafer Gashi: Vetëm një sqarim i vogël, shuma 20 mijë euro te ndërtimi me gurë i sheshit të qytetit, si e keni menduar ndërtimin? – Me kubëza apo me gurë.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Janë obligime që kanë mbetur gjatë viteve për sheshin e qytetit.

Kryesuesi e vuri në votim dhe me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Vendimit për shfuqizimin e vendimit për shpalljen e zonës me interes publik në Çabiq.

Kryesuesi theksoi se është fjala për vendimin e marrë në mandatin e kaluar për ndërtimin e një rezervuari akumulues të ujit. Ai e vuri në votim shfuqizimin e vendimit në fjalë dhe me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA. Më pastaj kërkoi nga drejtori që ta merr fjalën.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: e përmende arsyen e kërkesës për shfuqizimin e vendimit të parë që ka të bëjë me parcelën nr. 001-09/2, 98 ari, ndërsa në vendimin e ri me nr. 001-09/4 ne si komunë kemi nevojë për 15 ari e 27 metra, nuk kemi nevojë më shumë. Kjo ka qenë arsyeja e kërkesës sonë.

Kryesuesi e vuri në votim dhe me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndarjen e parcelës për ndërtimin e ndërtesës së zjarrfikësve.

z.Besnik Marku, drejtor i Gjeodezisë: Përshëndetje për të gjithë. Arsyeja e këtij vendimi është sepse parcela ekzistuese sipas hartave zonale nuk është destinuar për shërbim. Përveç kësaj parcela ekzistuese është në pronë të dispanzerit të Pejës. Lokacioni ku ekziston stacioni policor është në hartë zonale- zonë shërbyese në pronësi të komunës dhe prandaj lokacioni që dëshirojmë të ndajmë për zjarrfikës në afërsi të stacionit policor është lokacion që ka disa përparësi si rruga kryesore afër, stacioni i policisë afër, hapësirë e mjaftueshme si dhe shumë arsye të tjera. Kjo na ka bërë që t'ju drejtohem me këtë propozim vendim për ndryshim të lokacionit dhe një pjesë e lokacionit të stacionit policor të ndahet për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve.

Edhe ky propozim vendim me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 10 e Rendit të Ditës

Kryesuesi sqaroi se Kuvendi do të i dërgojë tre anëtarë dhe unë ju propozoj që këta tre anëtarë të jenë nga AAK një anëtar, nga PDK një anëtar dhe nga LDK një anëtar.

z. Tunë Dedaj: Ne pajtohemi me këtë propozim dhe nga AAK propozojmë që të jetë z. Valmir Bacaj.

Nga LDK u propozua z. Enver Gashi dhe nga PDK u propozua, z. Esat Raci.

Këto propozime i vuri në votim kryesuesi dhe me 26 vota për U MIRATUA.

Pika 11. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për formimin e Këshillit Organizativ të Festivalit "I këndojmë lirisë"

Kryesuesi theksoi se në lidhje me organizimin e festivalit në fjalë ekziston një vendim i vitit 2002 i cili ose duhet të respektohet ose të shfuqizohet dhe se ky vendim gjithashtu duhet të ndryshohet sepse në pikën 2 të këtij vendimi thuhet se festivali mbahet me datën 5 dhe 6 qershor e në fakt festivali që 19 vite mbahet me datat 6, 7 dhe 8 qershor. Ndërkaq pika 3 e këtij vendimi thotë se punët organizative rreth këtij festivali i kryen drejtoria kompetente që është DKRS. Pra nuk ka nevojë që kuvendi të formon këshill organizativ pasi që sipas këtij vendimi atë e bënë drejtoria përkatëse. Kryesuesi kërkoi nga anëtarët e kuvendit që të deklarohen se a duan ta shfuqizojnë këtë vendim apo vetëm ta ndryshojnë pikën ku përcakton datat e mbajtjes së festivalit. Rreth kësaj u deklaruan të gjithë shefat e grupeve kuvendare, z.Esat Raci, z.Valmir Baca, z.Arben Limanaj dhe z. Zafer Gashi dhe të gjithë unanim ishin që ky vendim i vitit 2002 të ndryshohet vetëm në pikën ku përcakton datat e mbajtjes, pra të bëhet 6, 7 dhe 8 qershor dhe të mos ndryshohet asgjë tjetër. Kryesuesi fillimisht e vuri në votim shfuqizimin e vendimit ku me vota unanime u MIRATUA shfuqizimi dhe më pas e vuri në votim Vendimin më datat e ndryshuara 6, 7 dhe 8 qershor dhe me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 12 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i kryetarit të komunës me qytetarë për vitin 2021.

Procesverbali në fjalë u MIRATUA me vota unanimit.

Pika 13 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KKSB për vitin 2022

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ky plan i punës parasheh të gjitha aktivitetet e nevojshme bazuara në nevojën dhe tematikat që do të realizohen në kuadër të mbledhjeve të KKSB, të gjitha këto aktivitetet kanë koston 8000 euro që ka të bëjë me mëditjet e anëtarëve të këtij Komiteti.

z. Arben Limanaj: Nuk e di a e keni shikuar mirë miratimin e planit të punës pa u formuar akoma komiteti në fjalë. Ndoshta duhet që të jetë i formuar si komitet e më pastaj të miratohet plani i punës.

z. Fadil Gashi, kryesues: Udhëzimi administrativ e shpjegon se këtë komitet e udhëheq kryetari i Komunës dhe nuk besoj që shkelet ligji. Anëtarët e ardhshëm mund ta ndryshojnë kur të duan gjithmonë përmes kuvendit. Proceduralisht nuk bëjmë asnjë shkelje.

Kryesuesi e vuri në votim dhe me 26 vota për U MIRATUA.

Pika 14 e Rendit të Ditës: Propozim vendim për themelimin e 5 komiteteve të tjera.

(u kërkua pauzë 15 minutash)

U propozuan këta anëtarë :

Komiteti për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale; 1.Shemsedin Berisha, 2.Illirjana Toplanaj, 3.Visar Veselaj, 4.Rita Maxharraj. 5.Marigona Raci.

U votua dhe me vota unanime U MIRATUA.

Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport: 1.Florentina Berisha, 2.Nikson Dakaj, 3.Kushtrim Haliti, 4.Miftar Raci, 5.Lirije Gashi.

U votua dhe me vota unanime U MIRATUA.

Komiteti për planifikim urban, ekonomi dhe zhvillim: 1.Kolë Prenaj, 2.Xhezide Trepça-Gashi, 3.Azdren Ramadani, 4.Ndrec Zefaj, 5.Xhafer Berisha.

Me vota unanime U MIRATUA.

Komiteti për Shërbime Publike: 1.Armend Beqiri, 2.Luigj Ademi, 3.Arta Pantina, 4.Basri Gashi, 5.Albert Haxhaj.

Me vota unanime U MIRATUA.

Komiteti për pronë: 1. Arlinda Selitaj, 2. Valmir Bacaj, 3. Riad Millaku, 4. Zef Ceta, 5. Azem Ukaj.

Me vota unanime U MIRATUA.

Kryesuesi konstatoi se u themeluan 5 komitetet .

Pika 15 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje.

z. Zafer Gashi: Pyetjet i kemi bërë paraprakisht me shkrim. Po i lexoj në vazhdim. Për DKA: A mund të na njoftoni me emra të profesorëve me titullin master që kanë dhënë mësim në SHM profesionale "Fehmi Agani" dhe nga cila ditë janë paguar këta mjekë mësimdhënës? Për Shëndetësinë, z. Bacaj – drejtor, kemi kërkuar që të na njoftojë me listën e honorarëve të paguara në QKMF gjatë vitit 2021, gjatë kohës së fushatës, sidomos në tre mujorin e fundit si dhe të na njoftoj me listën e të punësuarve në këtë institucion gjatë kohës së fushatës. Për kryetarin e Komunës, z. Zenun Elezaj, pyetja është: Deri ku shkuar procedura e dhënies së lejes për ndërtimin e fabrikës së Çimentos? Si dhe sa është numri i të punësuarve në Komunë në këta tre muajt e fundit?

I nderuar kryesues, unë do të lexoj edhe një ankesë. Kam marrë preferenca nga miqtë që këtë ankesë ta lexojë dikush nga asamblistët e LVV por nisur nga fakti se është bërë personalisht ndaj meje dhe biznesit tim, dua ta lexoj vet.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Përshëndetje për të gjithë. Falënderoj për pyetjen z. Gashi. Sa i përket emrave që i ka kërkuar, kujtoj që DKA ka pasur marrëveshje me drejtorinë e Shëndetësisë për angazhim të stafit. Nëse është e nevojshme mund t'i përmendi edhe emrat. Ka qenë znj. (këtu ndërhyjnë kryesuesi dhe duke kërkuar mirëkuptim që të mos përmendet asnjë emër). Ndërsa sa i përket pagesës së këtij stafi të angazhuar në shkollë, pagesa është bërë nga QKMF për punë shtesë. Për shkollën në Përçevë dhe mungesës së lëndës djegëse, ju informoj se asnjë ditë nuk ka mbetur pa lëndë për ngrohje por që është e vërtetë se kemi pasur vështirësi në furnizim.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: Të nderuar të pranishëm. I kam marrë me kohë pyetjet. Dhe po përgjigjem: Po e nisi nga pyetja e fundit dhe kërkesa për tre mujorin e fundit. Sot jemi në fund të muajit shkurt dhe nuk mund të dijë se në muajin Mars, pra në muajin e tretë a ka me pasur konkurs dhe kush do të punësohet. Në vitin 2021 kanë qenë 11 punësime gjithsej. Është përfshirë stafi i mesëm dhe mjekë. Janë 4 konkurse të shpallura që asnjëri nga këto konkurse nuk është shpallur gjatë kohës së balotazhit zgjedhor. Një konkurs ka qenë i shpallur brenda periudhës së zgjedhjeve të rregullta që ka pasur të bëjë me punësimin e dy mjekëve. Është punësuar një mjek nga Komuna e Pejës pasi që nuk ka pasur kuadro të atij profili me licencë nga Komuna e Klinës dhe një tjetër mjek nga Komuna e Klinës. Konkurset e tjera për pesë mjekë janë zhvilluar në etapa të tjera. Dhe një konkurs për drejtor të QKMF që është zhvilluar në muajin Gusht të 2021. Sa i përket honorarëve, kam sjellë listën e njerëzve që kanë marrë honorar në QKMF por paraprakisht më duhet t'ju njoftoj me një vendim të marrë nga

Kryetari i Komunës që ka të bëjë me ndalimin e marrjes së kompensimeve shtesë nga ana e drejtorëve që ka të bëjë me stafin administrativ. Ju e dini, edhe Zafi e din, që kjo nuk vlen për stafin shëndetësor sepse stafi shëndetësor punon në festa, ditëve të vikendit, ndërrimin e natës dhe paguhen për kujdestari. Unë i kam të gjitha listat me vete me emra e mbiemra por nuk mundem me e publiku. Është një procedurë tjetër për pajisje me këto dokumente që posedojnë të dhëna personale, referojuni zyrtarit për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare. Kam me vete gjithashtu listën e të hyrave vetanake që mendoj se është në interes edhe të publikut edhe të anëtarëve të Kuvendit. Ju informoj se të hyrat vetanake që grumbullohen në shtëpi të shëndetit janë më të mëdha se sa shpenzimet që janë. Nëse ju keni interes për këto të dhëna mund të jua përcjell me e-mail. Faleminderit shumë.

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Përshëndetje për të gjithë. Sa për procedurë të gjitha të dhënat merren nga zyra e personelit. Zyra e personelit është në kuadër të Administratës. Shënimet e të gjitha konkurseve dhe punësimeve gjatë periudhës që ju keni bërë pyetjen i kam marr nga zyra e personelit. Kërkesa e juaj ka të bëjë me numrin e të punësuarve në tre mujorin e fundit. Ju informoi se procedura e rekrutimit ka qenë e vështirësuar në dy vitet e fundit. Ligji për zyrtarët publik ka hy në fuqi në vitin 2019, prej shtatorit të 2019 nuk kemi mundur që të zhvillojmë asnjë procedurë. Si komune kemi pasur vështirësi pasi që ju e dini shumë zyrtarë kanë dalë në pension por edhe disa nga zyrtarët fatkeqësisht kanë ndërruar jetë. Deri në momentin që na është dhënë mundësia e hapjes së procedurave për rekrutim i kemi zëvendësuar. Me aprovimin e ligjit për zyrtarë publik me nr. 06-114 dhe rregullores për pranim nr. 16/2020, kemi filluar dhe përfunduar gjithsej 10 procedura gjatë kësaj periudhe që ju e keni kërkuar sqarimin. Të gjitha procedurat janë zhvilluar në mënyrë të rregullt. Jemi komuna e parë në nivel të Kosovës që kemi zhvilluar procedura të tilla. Procedura e intervistimit nuk zhvillohet më në Klinë por në ministrinë e punëve të brendshme duke u proceduar në këtë formë: Konkursi i parë hapet si konkurs i brendshëm që kanë të drejt të konkurrojnë të gjithë zyrtarët publik në nivel vendi. Pas kësaj mund të kalohet në procedurën tjetër që është procedurë e jashtme në të cilën konkurrojnë të gjithë qytetarët e interesuar. Në rastin tonë janë respektuar të gjitha kriteret. Pra janë zhvilluar 10 procedura dhe janë pranuar 10 zyrtarë në Komunën tonë.

Zoti Sylaj duke e përfunduar fjalën e tij përmendi konkretisht se në cilat drejtori e dikastere janë pranuar 10 zyrtarët publik në Komunë e Klinës.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Ju njoftoj se me datën 22.12.2021 e kam marr ë detyrën si drejtor i urbanizimit ku kam konstatuar se OE Walingford int, me përfaqësues z. Fatos Ismaili, kishte aplikuar për leje ndërtimi- objekt industrial gjegjësisht fabrikë, me datë 14.10.2021. Ne si drejtori përkatëse kemi analizuar tërë dokumentacionin e dosjes së aplikimit dhe kemi konstatuar se lejes së ndërtimit i kanë paraprirë të gjitha pëlqimet e lëshuara nga ministria e linjës si dhe organet kompetente. Prandaj me datë 25.01.2022 operatori i sipërpërmendur është pajisur edhe me leje ndërtimi të kategorisë së dytë. Leje e lëshuar në bazë të dy kriterëve; Pëlqimin për

shfrytëzim të lëndës së parë e lëshuar nga Ministria e Ambientit, e lëshuar më datë 17.03.2021, Pëlqim për ndryshim të destinimit të tokës me datë 02.03.2020 lëshuar nga Ministria e bujqësisë, kushtet ndërtimore nga drejtoria e urbanizimit, Vendimin për pëlqimin mjedisor të lëshuar nga ministria e ambientit. Gjithashtu Pëlqimin për mbrojtje nga zjarri nga dikasteri përkatës, Pëlqim nga KEDS, nga PTK, nga kompania rajonale "Hidrodrini" që e kanë datën 2021, Certifikatë e pronësisë me nr. 11-2950-41/ 3. 09. 2021, Kopje të planit, përgjigje në kërkesën për kategorizimin e tokës- nga ministria e ekonomisë, Licencën e marrë nga KPMN dhe shumë dokumente të tjera që i disponon drejtoria e urbanizimit. Në fund vlen të theksohet se sipas PZHK dhe hartave zonale të miratuara në këtë asamble, kjo zonë është zonë minerare dhe ka marr ligjshmërinë nga ministria e pushtetit lokal. Dokument të cilit ne i referohemi. Ju faleminderit.

z. Zafer Gashi: Vëllezër të dashur, kam kërkuar nga kryetari i komunës të përgjigjet. Nuk dyshoj që drejtori është i sinqertë dhe punëtor. Me trego drejtor a është data 13.05.2020 kur ka marr pëlqimin nga ministria e ambientit?

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Po datë kur me qeverinë ka udhëheq partia e juaj.

Kryesuesi ndërhyr duke tërheq vërejtjen se nuk mund të bëhet debat interaktiv shkaku se nuk mund të mbahen shënime në procesverbal.

z. Esat Raci: Për drejtorin e urbanizimit. A jeni të njoftuar me vendimin e kuvendit të datës 5 mars 2020? A keni bërë shkelje duke dhënë leje për ndërtim të kësaj fabrike? Për drejtorin e shëndetësisë- a janë të gjitha AMF-të funksionale si dhe a ka barnatore kujdestare qyteti i Klinës?

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Sa i përket pyetjes se a ka shkelje ligjore, unë jam i njoftuar me të gjitha vendimet që ju i keni shkëmbyer me ministrinë e pushtetit lokal dhe me KPMN. Derisa nuk ka ligjshmëri të vendimit të Kuvendit ne nuk mund të veprojmë sipas atij vendimi.

z. Esat Raci: Drejtor, si ndjehesh moralisht për peticionin e 5000 qytetarëve kundër dhënies së lejes që ju e keni dhënë?

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Unë e respektoj ligjin. Jemi shtet ligjor dhe duhet ta respektojmë ligjin.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Në lidhje me AMF-të, shumica prej tyre janë funksionale. Gjatë vitit të kaluar kemi bërë investime kapitale në disa AMF, ndërsa jemi në proces të investimeve edhe në AMF-të e tjera. Sa i përket barnatoreve në qytet, ju e dini se ne nuk mund të interferojmë tek sektori privat. Vendimin për kujdestari të barnatoreve private e marrin vet ato, ne nuk mund të ndërhyjmë. Përndryshe barnatorja që është funksionale brenda QKMF-së është e furnizuar me barna. Ajo punon edhe gjatë vikendit por edhe gjatë natës. E kam listën e barnave që gjenden në barnatoren e QKMF-së, është investim i kryetarit Elezaj në këtë drejtim duke bërë që qytetarët tanë t'i kenë të gjitha barnat e nevojshme në këtë barnatore pa pasur nevojë për pagesë.

z. Arben Limanaj: E kam një kërkesë për drejtorin e Urbanizimit. E dimë që në planifikimet komunale ka hyrë bashkë më dy sheshe të tjera edhe sheshi "Ibrahim Rugova". A është proceduar projekti në lidhje me këtë shesh këtë vit. Dhe e dyta ka të bëjë me pyetjen që e kam parashtruar seancën e kaluar e që nuk kam marr përgjigje: A është respektuar udhëzimi administrativ për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave?

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Në lidhje me pyetjen e z.Limanaj, dëshiroj që përgjigjen ta jap në seancën e ardhshme.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: E kam shikuar dhe mendoj që është respektuar udhëzimi në fjalë.

z. Zafer Gashi: Unë e kam një shqetësim personal. Është shkelje e rëndë ligjore. Është vendim i marrë nga kryetari i Komunës për revansh politik. Dua t'i njoftoj qytetarët se ky vendim i kryetarit është shkelje e betimit të tij të bërë me 7 dhjetor dhe në dëm të qytetarëve dhe bizneseve. Biznesi im "Biolab Zafi " ka bërë kërkesë për me e rivendosë reklamën në vendin që është për 20 vite. Me datë 04.02.2022 deri me datën 21.02.2022 nuk kam marrë përgjigje dhe kur e kam marrë vendimin ka qenë Refuzim. Po e lexoj çka shkruan në arsyetim: Komisioni konstatoi se vendosja e reklamës së tij e pengon pamjen vizuale të QKMF në Klinë. Kjo të nderuar është shkelje ligjore, e rëndë. (z. Gashi prezanton me foto se si ka qenë më parë gjendja e asaj hapësire dhe se si është planifikuar të bëhet). Kryetari thotë se ja ke ndalë pamjen QKMF, mos thuaj kryetar që ia kam ndalë pamjen edhe Xhamisë në krahun tjetër. Thirret në rregulloren për shfrytëzim të pronave. Kjo rregullore thotë, neni 6- kriteret për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Të jetë e regjistruar si pronë në regjistrin kadastral të komunës si pronë e Komunës.- Të jetë e lirë ndaj obligimeve të palëve të treta, - Të mos ketë kontest pronësor, - të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor, - Të plotësojë kriterin mjedisor, - Të ketë arsyeshmëri për interesin publik, - Të ndikojë në rritjen dhe zhvillimin në të mirë të Komunës, - Të ndikojë në rritjen e vlerave të diversitetit arsimor, kulturor, sportiv. Të gjitha këto kriteret të kërkuara janë plotësuar por është refuzuar. Ankesa gjithsesi që do të bëhet por unë do ta porosis një pano të madhe me portret të kryetarit tonë dhe do ta vendos aty, të shohim a do të vijnë ta heqin pastaj me arsyen se e ka zënë pamjen e QKMF-së. Unë kërkoj seriozisht që ta ndalë presionin ndaj familjes time sepse edhe vllahut tim ia kanë bërë të pa drejtë. E respektoj, kam qenë shok i tij, e lus që të mos e shkel ligjin sepse qytetarët janë të barabartë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Zaf, ti po e përmend emrin tim por emri im nuk është askund në atë vendim e në kundërthëniet që i thekson. Ne jemi ballafaquar në fushatë, por fushata ka kaluar tashmë. Të lutem aty nuk është i shkruar emri im mos e përmend emrin tim. Unë vërtetë jam kryetar komune por nuk merrem me ato gjera që i theksuat. Unë nuk jam armik i familjes tënde, unë jam mik i familjes tënde. Kam marr shërbime prej teje. Është komisioni adekuat që është marrë me kërkesën tënde jo unë.

Znj. Besjana Gashi: Të nderuar të pranishëm. Për drejtorinë e arsimit kam një kërkesë që ka të bëjë kryesisht me fshatin Çabiq. Kërkoj që nxënësit e fshatit të përfshihen në kuadër të transportit për udhëtim që të kenë një qasje më të lehtë për vajtje ardhje në shkollë.


z. Tunë Dedaj: Dua ta pyes drejtorin e Bujqësisë se deri ku ka shkuar procedura e fillimit me furnizim me sera të bujqve?

z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Kanë përfunduar procedurat dhe tani është një kompani fituese. 10 ditë e kemi afatin që të aplikojnë qytetarët dhe pas 10 ditëve fillohet me vlerësimin e kërkesave të qytetarëve. Besoj se nga fundi i marsit gjithçka do të jetë gati.

Kryesuesi z. Fadil Gashi i mbylli punimet e kësaj seance me kërkesën që në seancën e radhës të gjithë të jenë të përgatitur se vetëm 15 minuta do të i kushtohen pikës së rendit të ditës “ Pyetje dhe Përgjigje”.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

